



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary


DATË/A:	12.01.2026
REFERENC-Ë:	25/3998/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Runfill" Sh.p.k. Arbanë, Barikadat, Prizren, Fabrikë e prodhimit të produkteve për pastrim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, Dushanovë, Prizren
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Runfill" Sh.p.k. Arbanë, Barikadat, Prizren me Nr.Prot.25/3998/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë e prodhimit të produkteve për pastrim- detajim, shamponëve dhe aromave për makina, Dushanovë, Prizren.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/3998/MMPHI
Datë: 12.01.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafin 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Ndërpritet procedura administrative e shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot. 25/3998/MMPHI për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për operatorin "Runfill" Sh.p.k. Arbanë, Barikadat, Prizren, për veprimtarinë: Fabrikë e prodhimit të produkteve për pastrim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, në ngastrën kadastrale nr.00314-9, zona kadastrale Dushanovë, Prizren.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/3998/MMPHI për operatorin "Runfill" Sh.p.k. Arbanë, Barikadat, Prizren, për veprimtarinë: Fabrikë e prodhimit të produkteve për pastrim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, në ngastrën kadastrale nr.00314-9, zona kadastrale Dushanovë, Prizren, MMPHI

konstaton se operatori **nuk i ka plotësuar** kushtet administrative për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në një kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 811233775, datë: 18.06.2015, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqimin Mjedisor, Nr.24/2446/1-ZSP/ /24, datë: 05.07.2024, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Certifikatën e përdorimit ose një dokument nga Komuna e Prizrenit, për lejimin e ushtrimit së veprimtarisë me numrin e ngastrave, në përputhje me kërkesën për Leje Mjedisore dhe Pëlqim Mjedisor.

Operatori ka sjellë një dokument nga Komuna e Prizrenit, pas afatit, i cili nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, **ndërpret procedurën administrative** për shqyrtimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/3998/ZSP/ /25 datë: 12.01.2026

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Prizren;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për Komunikim me Publikun të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.